



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1853/7 prot.

Datë 29.07.2025

V E N D I M

Nr. 971/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46807-05-02-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 lekë, zhvilluar në datë 04-06- 2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomië "B&A-02" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Top Oil” SHPK për procedurën e mësiperme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kappa” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHA me NIPT (J91402501L), me adresë: Zona Kadastrale 2547, Nr.Pasurie 159/182, Vol 19, Fq 219.

"B&A-02" SHPK me NIPT K21720007H dhe adresë Njesia Bashkiake ne 1, Lagji nr 1, Rruga Shemsie Haka, Ish Poligrafiku, Perballe Kryegjyshates.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Subjekt i interesuar:

“Top Oil” SHPK me NIPT J93316615M dhe adresë Gjirokaster, GJIROKASTER JERGUCAT. 2 “Kappa” SHPK me NIPT J91402501L dhe adresë Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Zona Kadastrale 2547, Nr.Pasurie 159/182, Vol 19, Fq 219

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Kappa” SHA dhe operatori ekonomik ankimues “B&A-02” SHPK, kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “Kappa” SHA dhe operatori ekonomik ankimues “B&A-02” SHPK, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46807-05-02-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 lekë, zhvilluar në datë 04-06- 2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 26.06.2025, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “KAPPA - OIL ” SH.A 35.033.200,00 Skualifikuar (Nuk permbush piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik per arsyen si meposhte : • Per artikullin Nr 40 “Solucion pastrimi radiator” operatori ekonomik ne permbushje te kriterit 2.3.4 ka paraqitur ne SPE Skede Teknike te markuar artikullin e emertuar “STOP LEAK”. KVO nga verifikimet e pershkrimit ne skeden teknike te paraqitur nga OE, konstaton se ky artikull nuk eshte solucion i cili ka te beje me pastrimin e radiatorit por eshte produkt i cili sherben per mbylljen e carjeve duke ndaluar rrjedhjet ne sistemet e qarkullimit te ujit, pra eshte i ndryshem nga artikulli i kerkuar ne DT.)
2. “B&A-02” SH.A 35.491.250,00 Skualifikuar (Nuk permbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik pasi nuk ka ngarkuar ne SPE Licence per tregetimin e vajrave (Kodi: VIII.1.A “Tregetimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perfshire ato bio si dhe lendet djegese”).
3. “TOP-OIL” SHPK 37.708.850,00 Kualifikuar
4. “VELLEZERIT AGALLIU 20” SH.A 44.328.500,00 Skualifikuar
5. “EXIMOIL” SHPK 49.561.900,00 Kualifikuar
6. “AUTO MANOKU” SHPK 54.578.810,00 Kualifikuar
7. “KADIU ” SHPK 62.225.630,00 Kualifikuar
8. “DEGERT AUTO” SH.A 65.500.930,00 Kualifikuar
9. “ELBA-OIL 2015” SHA 74.498.500,00 Kualifikuar

II.3. Në datën 04.07.2025, autoriteti ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraparak për procedurën e prokurimit publik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Në datën 11.07.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5546, dhe me nr. protokoli 1853/2025 datë 11.07.2025 e operatorit ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46807-05-02-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 lekë, zhvilluar në datë 04-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i bdryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1853/1 prot., datë 11.07.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK

kundërshton me anë të ankesës me nr. 1853 protokolli, datë 11.07.2025, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.4.2. Më datë 12.07.2025, operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK ka paraqitur Informacion shtesë në përmbajtjen e të cilit konstatohen shpjegime lidhur me artikullin pastrues radiator, ardhur nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 1853/2 prot., datë 14.07.2025.

II.4.3. Me shkresën nr. 1393/14 prot., datë 18.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1853/3 prot., datë 21.07.2025 me objekt “Informacion” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi K.SH.A 70/2025 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “KAPPA - OIL” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim edhe dokumentacionin teknik më të detajuar, pjesë e formularit të ankesës, në të cilin përshkruhen në mënyrë më shpjeguese të dhënat dhe funksionet e këtij solucioni, konkludon se specifikimet teknike për artikullin me nr.40 "Solucion pastrim radiator", konsiderohen të përmbushura. Sipas standardeve teknike të aplikimit të aditivëve në sistemet e ftohjes, një produkt si "Stop Leak", i cili përmban aditivë dispersues, antikorrozivë dhe agjentë lubrifikues, vepron jo vetëm për të bllokuar rrjedhjet, por edhe për të shpërndarë depozitat e ndryshkut dhe mbetjeve që ndodhen në qarkullimin e lëngut ftohës. Kjo e bën atë funksionalisht të barasvlershëm me shumë produkte komerciale për pastrimin e radiatorëve.

Nga pikëpamja ligjore, nëse përmbajtja kimike e një solucioni përmbush të njëjtat funksione teknike të një pastruesi – siç janë: shpërndarja e papastërtive, përmirësimi i qarkullimit të lëngut, dhe neutralizimi i depozitave të oksidimit - atëherë ai mund të kualifikohet funksionalisht si produkt me përdorim të dyfishtë, sipas parimit të barazisë funksionale në legjislacionin e konsumatorit dhe të tregut të lirë të produkteve.

Pra, nga pikëpamja teknike dhe ligjore, nëse një produkt përmbush efektivisht funksionet pastruese, atëherë ai ligjërisht mund të përdoret dhe klasifikohet si pastrues, pavarësisht etiketimit të tij fillestar si "Stop leak". Emërtimi "Stop Leak" përbën një emër tregtar apo komercial, jo një përshkrim teknik të plotë të funksioneve të produktit. Sipas praktikës së zakonshme në treg dhe parimeve të së drejtës së konsumatorit dhe industrisë, emërtimet komerciale shpesh nuk përfaqësojnë tërësinë e funksioneve të një produkti, por shërbejnë për identifikim të thjeshtuar dhe marketim.

KSHA gjykon se ajo që përcakton përdorimin real të një produkti nuk është emërtimi tregtar, por përbërja kimike, funksioni dhe efekti i tij gjatë përdorimit praktik. Pra, edhe nëse një solucion

etiketohet si "Stop Leak", nëse në një analizë të të dhënave teknike/katalog konstatohet përmbajtja e komponenteve që pastrojnë sistemin, si dispersantë, inhibitorë të korrozionit, apo aditivë kimikë që shpërbëjnë grimca, atëherë funksioni i tij real përfshin edhe pastrimin, pavarësisht emërtesës.

Pra, emërtimi "Stop Leak" është një emër tregtar i fokusuar në një nga funksionet e produktit - ndalimin e rrjedhjeve - por ai nuk kufizon ligjërisht apo teknikisht përdorimin e produktit vetëm për këtë qëllim. Bazuar në përbërjen dhe efektet reale, ky solucion kryen edhe funksion pastrues, dhe ky fakt ka më shumë peshë sesa emërtimi komercial në vetvete.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe përmbajtjen e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kishte detyrimin të përzgjidhte ofertën më të favorshme ekonomikisht, që në rastin konkret do të thotë oferta me çmimin më të ulët, për atë kohë sa përmbush kërkesat teknike minimale. Referuar ofertës në tërësi të operatorit ekonomik ankimues "KAPPA-OIL" sha konstatohet se produkti i ofruar sipas artikullit nr. 40 të specifikimeve teknike ka funksionalitet të superuar/tejkualuar, pra me kushte më të mira nga ai i kërkuar, si edhe duke mbajtur në konsideratë faktin që kjo ofertë përbën çmimin më të ulët, ky skualifikim konsiderohet si i pasaktë.

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "KAPPA OIL" sha."

II.4.4. Në datë 17.07.2025 me shkresën protokolluar me tonën nr. 1859/2 datë 17.07.2025 është paraqitur formulari argumentave nga operatori ekonomik "TOP-Oil" SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të "Ligjit për prokurimin publik" i ndryshuar në cilësinë e palës së interesuar, që ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohet nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik "Kappa-Oil" SH.A, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2025/5549 datë 12.07.2025 dhe me nr. 1859/2025 prot., datë 14.07.2025, të operatorit ekonomik "B&A-02" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me nr. REF-46807-05-02-2025 me objekt: "Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori", me fond limit 83,967,400.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1859/1 prot., datë 14.07.2025. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "B&A-02" SHPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Top Oil” SHPK si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve për skualifikim të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Kappa” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.5.2. Në datë 17.07.2025 me shkresën protokolluar me tonën nr. 1859/3 datë 18.07.2025 është paraqitur formulari argumentave nga operatori ekonomik “TOP-Oil” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të “Ligjit për prokurimin publik” i ndryshuar në cilësin e palës së interesuar, që ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohet nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik "B&A-02" SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.3. Ndërsa në datë 21.07.2025 me shkresën protokolluar me tonën nr. 1853/4 datë 22.07.2025 janë paraqitur argumenta shtesë nga operatori ekonomik “Kappa Oil” SH.A sipas parashikimeve të nenit 113 të “Ligjit për prokurimin publik” i ndryshuar në cilësin e palës së interesuar, që ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohet nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik "B&A-02" SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.4. Me shkresën nr. 1393/20 prot., datë 22.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 24.07.2025 me objekt “Informacion” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi K.SH.A 71/2025 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues "B&A-02" SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "B&A-20" sha mbi s'kualifikimin e ofertës për mospërmbushjen e pikës 2.3.2 të Kapacitetit Teknik..., KSHA arsyeton se:

.....

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se paraqitja e dokumentit Leje Mjedisore e tipit A, jo vetëm e plotëson kriterin e përcaktuar në kapacitetin Teknik të dokumenteve të tenderit, por edhe e tejkalon atë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në referencë me kuadrin ligjor që rregulon këtë fushë si dhe duke mbajtur në konsideratë hapat kronologjikë të procesve të aplikimit dhe pajisjes me lejet dhe licencat përkatëse, konkludon se: Licenca sipas Kodit VIII.1.A përbën parakusht ligjor dhe faktik për të aplikuar për leje mjedisore, sepse

përcakton juridikisht aktivitetin dhe kapacitetin e subjektit, lejon autoritetet mjedisore të vlerësojnë ndikimet reale të një aktiviteti të ligjëruar dhe është kërkesë e qartë në ligjin për lejet mjedisore dhe aktet nënligjore për kete fushe.

Por, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konsideron gjithashtu faktin se në kuadër të procesit të vlerësimit dhe përmbushjes së kriterëve kualifikuese me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt ankimimi, është kërkuar posedimi i licencës së vlefshme si dokument kyç për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe teknike të aktivitetit. Megjithatë, ofertuesi ka paraqitur vetëm lejen mjedisore, pa siguruar licencën e kërkuar dhe duke qenë se licenca përbën një nga kriteret thelbësore për pranimin dhe vazhdimin e procedurës, mungesa e saj pengon vlerësimin e plotë dhe të saktë të ofertës.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

II.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "B&A-20" sha mbi s'kualifikimin e operatorit ekonomik "Kappa-Oil" SH.A per autorizimin e prodhuesit, KSHA arsyeton se:

....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik i klasifikuar si fitues paraprak, "Kappa-oil" sha, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin e kontestuar, konkretisht autorizim prodhuesi. Në dokumentin "Autorizim Prodhuesi" reflektohet që operatori ekonomik "Kappa oil" sha ka ofrur garanci të plotë lidhur me artikujt/zërat e kontratës objekt ankimimi, në cilësinë e prodhuesit. Operatori ekonomik "Kappa oil" sha ka deklaruar statusin e tij si prodhues, i cili është i provuar dhe i dokumentuar përmes regjistrimit të aktivitetit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Ky fakt garanton jo vetëm vlefshmërinë formale dhe materiale të dokumentacionit të paraqitur, por gjithashtu rrit transparencën dhe sigurinë ligjore të kontratës, objekt prokurimi, pasi ky operator ekonomik zotëron kontroll të plotë mbi zinxhirin e furnizimit, prodhimit si dhe tregtimit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "B&A-20" sha mbi s'kualifikimin e operatorit ekonomik "Kappa Oil" SHA për kataloget....., KSHA arsyeton se:

.....

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në përmbushje të specifikimeve teknike të përcaktuar në Shtojcën 6 të Dokumenteve të Tenderit, operatori ekonomik "Kappa oil" sha ka paraqitur katalogët përkatës, të cilët rezultojnë konform specifikimeve teknike respektive per secilin artikull.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se katalogët e paraqitur nga ky operator ekonomik janë të qartë, të detajuar dhe përmbajnë të gjithë informacionin teknik të nevojshëm, duke përfshirë përshkrimin e plotë të produkteve, karakteristikat teknike funksionale dhe fizike si dhe standardet e prodhimit dhe përputhshmërinë me normat përkatëse të cilësisë dhe sigurisë. Për më tepër, për çdo produkt të ofruar janë cituar qartë specifikimet që korrespondojnë me ato të kërkuara sipas dokumenteve të tenderit, duke mundësuar një verifikim të drejtpërdrejtë dhe të paanshëm të përputhshmërisë teknike.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se katalogët janë paraqitur në mënyrë të rregullt, të dokumentuar dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara, dhe si të tillë, përbëjnë dëshmi të vlefshme për vlerësimin teknik të ofertës dhe kualifikimin e saj.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "B&A-20" sha mbi s'kualifikimin e operatorit ekonomik "Kappa-Oil" sha për fletë-analizat..

.....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin lidhur me fletë analizat e kryera për artikujt me nr. rendor 6, 8, 10, 12, 13, 14 (sipas renditjes së artikujve në Shtojcën 6 "Formulari i Specifikimeve Teknike" konstaton konformitetin e tyre përkundrejt katalogut "Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbime", pjesë e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë prokurimi.

Në funksion të verifikimit të cilësisë së produktit të ofruar, operatori ekonomik "Kappa oil" sha ka paraqitur fletë-analizat përkatëse laboratorike, të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara mbi përbërjen dhe parametrat teknikë. Pas shqyrtimit të këtyre analizave, rezulton se treguesit teknikë dhe kimikë të matura, janë në koherencë me kufijtë e përcaktuar në standardet ligjore dhe teknike përkatëse, duke përfshirë edhe ato të specifikuara në dokumentet e tenderit. Në tërësi, vlerat e pasqyruara reflektojnë edhe përmirësime cilësore duke mbajtur në konsideratë jo vetëm përputhshmërinë funksionale, por edhe efektivitetin e lartë në përdorim, krahasuar me minimumin teknik të kërkuar.

Në këtë kuadër, fletë-analizat përbëjnë provë të besueshme dhe të vlefshme për cilësinë e produktit të ofruar, duke konfirmuar se ai është i sigurt, teknikisht i përshtatshëm dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "B&A-20" sha mbi s'kualifikimin e operatorit ekonomik "Top-Oil" sha.....

Së pari, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave referuar legjislacionit në fuqi të sipërcituar thekson se në kuptimin e legjitimitetit të ushtrimit të së drejtës së ankimimit përfshihet çdo person që pretendon se ka interes në një procedurë prokurimi, se është dëmtuar ose që rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor duke ju referuar një situatë konkrete për të provuar çënimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm, interes i cili individualizohet nga elementë konkretë si subjektet (palët) dhe shkaku (e drejta ose marrëdhënia juridike e çënuar që ndodhet në themel të ankesës).

Operatori ekonomik ankimues, që pretendon se i është çënuar një e drejtë apo interes i ligjshëm, apo që rrezikon t'i çënohet, duhet të identifikojë faktin që përbën çënimin e të drejtës ose interesit të ligjshëm si dhe të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete.

Në rastin konkret, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konsideron se operatori ekonomik ankimues nuk ka një interes të ligjshëm për të kundërshtuar kualifikimin e operatorëve të tjerë, në renditje pas tij, për sa kohë që në rastin konkret, oferta e tij është më e ulët në vlerë ekonomike krahasuar me ofertën e operatorit ekonomik "TOP-OIL" sha. Për rrjedhojë, statusi i operatorit ekonomik ankimues nuk ndryshon nga kualifikimi ose jo i operatorëve ekonomike me një vlerë oferte më të lartë.

Për sa më sipër, pretendimet i operatorit ekonomik ankimues lidhur me operatorin ekonomik "TOP-OIL" sha nuk merret në shqyrtim.

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "B&A-02" shpk."

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 11.07.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa online me nr. A/2025/5546 dhe protokolluar me nr. 1853/2025 datë 11.07.2025 e operatorit ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46807-05-02-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 lekë, zhvilluar në datë 04-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Në datë 17.07.2025 me shkresën protokolluar me tonën nr. 1859/2 datë 17.07.2025 është paraqitur formulari argumentave nga operatori ekonomik “TOP-Oil” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të *“Ligjit për prokurimin publik”* i ndryshuar në cilësinë e palës së interesuar, që ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohet nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “Kappa-Oil” SH.A, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Lidhur me pretendimet e ankimuesit KAPPA - OIL” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 1393/14 prot., datë 18.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1853/3 prot., datë 21.07.2025 me objekt “Informacion” ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimin e K.SH.A 70/2025 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “KAPPA - OIL” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]”

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim edhe dokumentacionin teknik më të detajuar, pjesë e formularit të ankesës, në të cilin përshkruhen në mënyrë më shpjeguese të dhënat dhe funksionet e këtij solucioni, konkludon se specififikimet teknike për artikullin me nr.40 "Solucion pastrim radiator", konsiderohen të përmbushura. Sipas standardeve teknike të aplikimit të aditivëve në sistemet e ftohjes, një produkt si "Stop Leak", i cili përmban aditivë dispersues, antikorrozivë dhe agjentë lubrifikues, vepron jo vetëm për të bllokuar rrjedhjet, por edhe për të shpërndarë depozitat e ndryshkut dhe mbetjeve që ndodhen në qarkullimin e lëngut ftohës. Kjo e bën atë funksionalisht të barasvlershëm me shumë produkte komerciale për pastrimin e radiatorëve.

Nga pikëpamja ligjore, nëse përmbajtja kimike e një solucioni përmbush të njëjtat funksione teknike të një pastruesi – siç janë: shpërndarja e papastërtive, përmirësimi i qarkullimit të lëngut, dhe neutralizimi i depozitave të oksidimit - atëherë ai mund të kualifikohet funksionalisht si produkt me përdorim të dyfishtë, sipas parimit të barazisë funksionale në legjislacionin e konsumatorit dhe të tregut të lirë të produkteve.

Pra, nga pikëpamja teknike dhe ligjore, nëse një produkt përmbush efektisht funksionet pastruese, atëherë ai ligjërisht mund të përdoret dhe klasifikohet si pastrues, pavarësisht etiketimit të tij fillestar si "Stop leak". Emërtimi "Stop Leak" përbën një emër tregtar apo komercial, jo një përshkrim teknik të plotë të funksioneve të produktit. Sipas praktikës së zakonshme në treg dhe parimeve të së drejtës së konsumatorit dhe industrisë, emërtimet komerciale shpesh nuk përfaqësojnë tërësinë e funksioneve të një produkti, por shërbejnë për identifikim të thjeshtuar dhe marketim.

KSHA gjykon se ajo që përcakton përdorimin real të një produkti nuk është emërtimi tregtar, por përbërja kimike, funksioni dhe efekti i tij gjatë përdorimit praktik. Pra, edhe nëse një solucion etiketohet si "Stop Leak", nëse në një analizë të të dhënave teknike/katalog konstatohet përmbajtja e komponenteve që pastrojnë sistemin, si dispersantë, inhibitorë të korrozionit, apo aditivë kimikë që shpërbëjnë grimca, atëherë funksioni i tij real përfshin edhe pastrimin, pavarësisht emërtesës.

Pra, emërtimi "Stop Leak" është një emër tregtar i fokusuar në një nga funksionet e produktit - ndalimin e rrjedhjeve - por ai nuk kufizon ligjërisht apo teknikisht përdorimin e produktit vetëm për këtë qëllim. Bazuar në përbërjen dhe efektet reale, ky solucion kryen edhe funksion pastrues, dhe ky fakt ka më shumë peshë sesa emërtimi komercial në vetvete.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe përmbajtjen e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kishte detyrimin të përzgjidhte ofertën më të favorshme ekonomikisht, që në rastin konkret do të thotë oferta me çmimin më të ulët, për aq kohë sa përmbush kërkesat teknike minimale. Referuar ofertës në tërësi të operatorit ekonomik ankimues "KAPPA-OIL" sha konstatohet se produkti i ofruar sipas artikullit nr. 40 të specifikimeve teknike ka funksionalitet të superuar/tejkualuar, pra me kushte më të mira nga ai i kërkuar, si edhe duke mbajtur në konsideratë faktin që kjo ofertë përbën çmimin më të ulët, ky skualifikim konsiderohet si i pasaktë.

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "KAPPA OIL" sha."

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : *“1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

“2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, **KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me ankesën e pranuar të nga autoriteti kontraktor** për me numër ankimi elektronik nr. A/2025/5546, datë 11.07.2025 dhe me nr. protokolli 1853/2025 datë 11.07.2025 e operatorit ekonomik “KAPPA - OIL” SHPK, pasi nuk rezulton të ketë ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji .

III.2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “B&A-02” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit

ekonomik “Top Oil” SHPK si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve për skualifikim të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Kappa” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “B&A-02” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij me pretendimin se : *“Për përmbushjen e këtij kriteri në si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi kemi dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronik dokumentacion si vijon: Pra nga sa më sipër referuar kriterit në pikën 2.3.2 të autoritetit kontraktor rezulton e provuar nga ana jonë se e përmbushim atë, pasi në kriter është përcaktuar se Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë Licence per tregjetimin e vajrave (Kodi: VIII.1.A itregetimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perfshire ato bio si dhe lendet djegeseë). Dhe per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri pavarisisht se nuk eshte kerkuar si detyrim paraqitja e nje dokumentacion ne kemi ngarkuar ne SPE dokumentin e sipercituar i cili ne emertimin pershkrues te veprimtarise eshte qartesisht e kuptueshme emërtimi përshkrues i veprimtarisë Autorizim mjedisor për pikë shërbimi për automjete (Autoservis, elektroaute, motorrist, etj) dhe tregtim të vajrave lubrifikantë të amballazhuara në funksion të aktivitetit. Ky dokument eshte leshuar per subjektin tone pra B&A-02, me NUIS/NIPT: K21720007H, ne adresen Rruga ishemi Hakaë, ish Poligrafiku, Kati i parë, Tirane. Ne menyre qe nje subjekt te pajiset me leje mjedisore per objektin specifik te aktivitetit duhet pikesepari te jete i ligjeruar per ushtrimin e ketij aktiviteti dhe dhe kete e verteton me se mire Licensimi i tij. Pra Licenca (ose regjistrimi në QKB për aktivitetin ekonomik) është parakusht ligjor që garanton se subjekti ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin. Pra, pa një licencë të vlefshme (ose regjistrim në QKB) që legjitimon aktivitetin, nuk mund të përmbushen kriteret formale dhe dokumentacioni që kërkohen për të aplikuar per leje mjedisore. Nese do ti referohemi neneve 36 e ne vijim te ligjit nr 10431 do te konstatojme se leja mjedisore jepet vetëm për aktivitetet të cilat janë paraprakisht të ligjshme (regjistruar/licencuar). Prandaj, nëse aktiviteti kërkon licencë, ajo është parakusht i domosdoshëm për marrjen e lejes mjedisore. Pra aktiviteti per kategorine e kerkuar nga autoriteti kontraktor qe subjektet duhet te jene te licensuar eshte VIII.1.A në Tregtim me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse. Ky aktiviteti kërkon leje mjedisore, leje e cila merret pasi subjekti të jete licensuar në përputhje me Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 ipër Licencat, Autorizimet dhe Lejet në republikën e shqipërisë, me Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 ipër Lejet e Mjedisitë, dhe VKM-së Nr. 538, datë 26.5.2009 për Licencat dhe Lejet që Trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa Rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtaë. Pra referuar bazez ligjore te sipercituar rezulton se nje Subjekt nuk mund të pajiset me leje mjedisore për tregti me shumicë vajrash pa patur më parë licencën përkatëse (VIII.1.A), sipas percaktimeve te Ligjit nr.10081 dhe VKM-së nr.538?Përkatës për këtë kategori. Beme gjithë kete paranteze per te kundërshtuar pretendimin e pa mbështetur te autoriteti kontraktor ne lidhje me skualifikimin tone nga kjo procedure prokurimi se ne si operator nuk paskemi paraqitur Licencen VIII.1.A në Tregtim me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse. Nderkohe qe ne ligjin e prokurimit publik theksohet se kriteret për kualifikim vendosen që tii shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Panorame te cilen ne e kemi permbushur duke i dhene informacion autoriteti kontraktor se ne si subjekt jemi te licensuar per kete lloj aktiviteti, disponojme jo vetem licencen VIII.1.A Per Tregtim me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve*

përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, por edhe Lejen Mjedisore me kod Kodi: III.1.A, me nr. PN-4466-11-2012, me emertim pershkrues te veprimtarise i autorizim mjedisor për pikë shërbimi për automjete (Autoservis, elektroaute, motorrist, etj) dhe tregtim të vajrave lubrifikantë të amballazhuara në funksion të aktivitetit. Ne jemi nje nga distributoret e kompanise me te madhe ne bote (Luk Oil) per tregtimin e vajit me shumice dhe pakice ne vendin tone, qe ne momentin e themelimit vitin 2002 dhe si te tille nuk do mund te operonim prej 23 vitesh ne treg pa qene te Licencuar dhe te pajisur me Leje Mjedisore per aktivitetin qe ne kryejme. Ne rast se autoriteti kontraktor ka patur dyshime ne lidhje me mos licensimin tone ka patur momentin procedural te verifikimit te kerkeses se percaktuar prej tij ne DST ne burime te hapura pra te aksesueshme nga kush do mjafton te bente nje kerkim ne faqen zyrtare te QKB konkretisht ne linkun e meposhtem <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-l-ejet-e-leshuara-nga-qkb/>.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Referuar shkresës nr. 1393/20 prot., datë 22.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 24.07.2025 me objekt “Informacion” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi K.SH.A 71/2025 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "B&A-02" SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "B&A-20" sha mbi s'kualifikimin e ofertës për mospërbushjen e pikës 2.3.2 të Kapacitetit Teknik..., KSHA arsyeton se:

.....

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se paraqitja e dokumentit Leje Mjedisore e tipit A, jo vetëm e plotëson kriterin e përcaktuar në kapacitetin Teknik të dokumenteve të tenderit, por edhe e tejkalon atë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në referencë me kuadrin ligjor që rregulon këtë fushë si dhe duke mbajtur në konsideratë hapat kronologjikë të procesve të aplikimit dhe pajisjes me lejet dhe licencat përkatëse, konkludon se: Licenca sipas Kodit VIII.1.A përbën parakusht ligjor dhe faktik për të aplikuar për leje mjedisore, sepse përcakton juridikisht aktivitetin dhe kapacitetin e subjektit, lejon autoritetet mjedisore të vlerësojnë ndikimet reale të një aktiviteti të ligjëruar dhe është kërkesë e qartë në ligjin për lejet mjedisore dhe aktet nënligjore për këte fushë.

*Por, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konsideron gjithashtu faktin se në kuadër të procesit të vlerësimit dhe përbushjes së kriterëve kualifikuese me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt ankimimi, është kërkuar posedimi i licencës së vlefshme si dokument kyç për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe teknike të aktivitetit. **Megjithatë, ofertuesi ka paraqitur vetëm lejen mjedisore, pa siguruar licencën e kërkuar dhe duke qenë se licenca përbën një nga***

kriteret thelbësore për pranimin dhe vazhdimin e procedurës, mungesa e saj pengon vlerësimin e plotë dhe të saktë të ofertës.”

III.3.2. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.3.3. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të vijojë me shqyrtimin e ankesës për pjesën tjetër të papranuar nga autoriteti kontraktor konkretisht pretendimin për përmbushjen ose jo të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik, pasi nuk ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, në përputhje me nenin 113 të këtij ligji, duke kundërshtuar vendimarrjen e autoritetit kontraktor, pra atë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.3.4. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“Shtojca 8

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete Licence per tregetimin e vajrave (Kodi: VIII.1.A “Tregetimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perfshire ato bio si dhe lendet djegese”).

III.3.5 Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kriterëve të kapacitetit teknik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “B&A-02” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur **Leje për autorizim mjedisor për pikë shërbimi për automjetet(autoservis, elektroaute, motorrist, etj) dhe tregtim të vajrave lubrifikantë të ambalazhuar në funksion të aktivitetit** si më poshtë:

LEJE	
NUIS/NIPT	Emërtimi përshkruar i veprimtarisë
Adresa Tiranë TIRANë Tiranë Adresa: Rruga Shemsi Haka, ish Poligrafiku, Kati i Parë	Autorizim mjedisor për pikë shërbimi për automjete (Autoservis, elektroaute, motorrist, etj) dhe tregtim të vajrave lubrifikantë të ambalazhuara në funksion të aktivitetit.
Kodi tjetër	Kufizime specifike
Data e lëshimit	
Afati i vlefshmërisë Pa afat	
Kategoria	Detyrime specifike
Nënkategoria Leje e thjeshtë mjedisore	Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjisllacionin në fuqi ,Bashkangjitur akti i miratimit për këtë aplikim.
Veprimtari specifike	Vendi i kryerjes së veprimtarisë
Specialiteti	Qarku: Tiranë Rrethi: TIRANë Tiranë B/K: Q/F: Adresa: Rruga e Durrësit (pranë institutit hidrometeorologjik).
	Nënshkrimi i sportelit

III.3.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “ 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të

favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.3.8. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për mallrave”, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“5. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose 39 c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

III.3.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret në kriterin kualifikues të sipërpërmendur autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të ketë Licence per tregetimin e vajrave (Kodi: VIII.1.A “Tregetimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perفشire ato bio si dhe lendet djegese”). Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresat me shkresën nr. 1393/20 prot., datë 22.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 24.07.2025 me objekt “Informacion” nëpërmjet të cilës është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi i K.SH.A 71/2025 rezulton se K.SH.A e autoritetit kontraktor ka *konsideruar faktin se në kuadër të procesit të vlerësimit dhe përmbushjes së kriterëve kualifikuese me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt ankimimi, është kërkuar posedimi i licencës së vlefshme si dokument kyç për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe teknike të aktivitetit. **Megjithatë, ofertuesi ka paraqitur vetëm lejen mjedisore, pa siguruar licencën e kërkuar dhe duke qenë se licenca përbën një nga kriteret thelbësore për pranimin dhe vazhdimin e procedurës, mungesa e saj pengon vlerësimin e plotë dhe të saktë të ofertës.*** Nga shqyrtimi i arsyeve të skualifikimit të sipërpërmendura në pikën II.2 të këtij vendimi, Komisioni gjykon se arsyet e skualifikimit të dhëna nga ana e autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ankimues nuk ka ngarkuar në SPE Licence per tregetimin e vajrave (Kodi: VIII.1.A “Tregetimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perفشire ato bio si dhe lendet djegese”) qëndron, pasi konstatohet që operatori ekonomik ka dorëzuar **Leje për autorizim mjedisor për pikë shërbimi për automjetet(autoservis, elektroaute, motorrist, etj) dhe tregtim të vajrave lubrifikantë të ambalazhuar në funksion të aktiviteti** që i përket kodit III.1.A dhe jo kodit VIII.1.A dhe nuk janë të njëjtë për nga funksioni pasi Kodi VIII.1.A i referohet tregtimit me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve

(përfshirë bio dhe djegëse të tjera) me fokus tek aktiviteti i specializuar tregtar dhe industrial që përfshin depozitimin, transportin, dhe shpërndarjen e lëndëve djegëse ndërsa Kodi III.1.A i referohet aktivitetit që ka ndikim të vogël mjedisor (p.sh. autoservis, tregtim vajrash të ambalazhuar për funksion teknik të serviseve) me fokus shërbime teknike për automjete dhe tregtim vajrash lubrifikantë të pakeluar, të cilët përdoren në funksion të shërbimit, jo për shpërndarje masive. KPP sqaron dhe njëherë se në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe se është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "B&A-02" sh.p.k., mbi shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Top Oil" SHPK, si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve për skualifikim të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë "Kappa" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, **nuk do të merren në shqyrtim** pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "B&A-02" SHPK do të vijnë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht i vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën që në këtë rast kur, operatori ekonomik ankimes mbetet i skualifikuar interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, ka humbur pasi pavarësisht pretendimeve të ngritura për operatorët e tjerë ekonomik "Top Oil" SHPK dhe "Kappa" SHPK, ai nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt – prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *"Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kappa” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24709-10-15-2024, me objekt “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-46807-05-02-2025 me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 83,967,400.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "B&A-02" SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për operatorin ekonomik “Kappa” SHPK.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kappa” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "B&A-02" SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

